



Prishtinë, 20 qershor 2018

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Së shpejti në prodhim edhe 32.4 MW energji elektrike nga BRE

Dje me 19 qershor 2018, Bordi dhe zyrtar të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) kanë zhvilluar një vizitë monitoruese në lokacionin Kitka të Komunës së Kamenicës, me qëllim të monitorimit të punimeve që po zhvillohen nga kompania “AIR Energy” për ndërtimin e kapaciteteve të reja të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE). Projekt ky i autorizuar nga ZRRE për ndërtimin e 9 turbinave të Erës me kapacitet prej 3.6 MW secila.

Përfaqësuesit e kompanisë “AIR Energy”, kanë njoftuar ZRRE-në me punimet që janë kryer deri më tani dhe kanë sqaruar se aktualisht janë në fazën përfundimtare dhe parashohin që brenda më pak se 3 muajsh të përfundojë ndërtimi dhe të futen në operim turbinat e erës të cilat kanë një kapacitet të përgjithshëm prej 32.4 MW.

Të kënaqur me ecurinë e projektit, anëtarët e Bordit të ZRRE, kanë sqaruar se kjo është vizita e parë monitoruese për këtë vit për monitorimin e projekteve të BRE-ve dhe se ditëve në vazhdim do të monitorohen edhe projektet tjera që janë duke u zhvilluar në pjesë të ndryshme të vendit. Në këtë mënyrë ZRRE do të informohet më për së afërmi me zhvillimet e këtyre projekteve por dhe do të njoftohet me vështirësitë të cilat po përballen investitorët gjatë realizimit të projekteve.

ZRRE mbetet e përkushtuar në mbështetjen e investimeve në fushën e BRE-ve, duke krijuar procedura pa barriera burokratike dhe kushte të përshtatshme rregullative me qëllim të vetëm që të përmirësohet furnizimi me energji dhe të arrihen caqet e vendosura nga Bashkimi Evropian për prodhimin e energjisë nga BRE-të. Si rezultat i këtij përkushtimi, deri më tani, janë 64 projekte që u janë nënshtruar procedurave të Autorizimit, nga të cilat 24 janë në proces të ndërtimit dhe 11 janë duke operuar.